



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.10, datë 15. 02. 2018

Për

“Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)”

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- | | | |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Ilir | Zela | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Anila | Denaj | Anëtar |
| 4. Znj. Ketrin | Topçiu | Anëtar |
| 5. Znj. Klarina | Allushi | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 15.02.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 68 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Pikës 1 të nenit 9 i ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Dixhital – Dividentit” (**ligji nr. 34/2017**);
3. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (**VKM Nr. 277**);
4. Shkresa e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.688 Prot., datë 15.02. 2018 “Për fillimin e procesit të këshillimit publik për frekuencat në brezin 800 MHz (792-860MHz), subjekt i mundshëm i të drejtave të kufizuara”.

5. Rregullore Nr.30, Datë 05.12.2013, “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor:

- Dokumenti: Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz) – Këshillim Publik (*Dokumenti*).
- Relacioni shoqërues mbi projektaktin miratues (*Relacioni*)
- Projektakti miratues i dokumentit (*Projektvendimi*);

si dhe, nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar

V Ë R E N s e :

1. AKEP-i administron një kërkesë të Ministrit për fillimin e procesit të këshillimit publik për frekuencat në brezin 800 MHz (792-860MHz), subjekt i mundshëm i të drejtave të kufizuara.
2. Sipas VKM nr. 277 frekuencat në brezin 800 MHz (792-860MHz) janë nën administrimin e AKEP.
3. Në mbështetje të pikës 2 të nenit 68 të ligjit nr. 9918/2008, me qëllim përmbushjen e politikave të zhvillimit në fushën e komunikimeve elektronike dhe parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Dixhital – Dividentit” lidhur me zbatimin e procedurës për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 800 MHz (792-860MHz), subjekt i mundshëm i të drejtave të kufizuara, AKEP mund të fillojë procesin e këshillimit publik me palët e interesuara për kushtet e përdorimit të këtij brezi të frekuencave dhe procedurën që mendohet të zbatohet për dhënien në përdorim të tyre.
4. Dokumenti për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.
5. Ky dokument është hartuar duke marrë parasysh:
 - Objektivat e politikës së zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike;
 - Planin Kombëtar të Frekuencave;
 - Rekomandimet e Bashkimit Evropian dhënë për Shqipërinë në lidhje me përdorimin e këtij brezi për shërbime të lëvizshme Broadband,

si dhe faktin që zhvillimi i infrastrukturës Broadband është në interes të zhvillimit ekonomik e social të vendit.

6. Dhënia në përdorim e këtyre frekuencave do të synojë:

- të nxisë një konkurrencë sa më efektive në tregun e komunikimeve elektronike dhe
 - përdorimin sa më të frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre.
7. Qëllimi i këtij këshillimi publik mbi dhënien në përdorim e këtyre frekuencave është marrja e mendimit të palëve të interesuara në mënyrë që:
- të krijojë një kuptim më të qartë për impaktin që do të ketë dhënia në përdorim e këtyre brezave;
 - të njohë interesin për marrjen në përdorim të tyre (numrin e kërkesave);
 - të njohë çmimin që janë të gatshëm të ofrojnë të interesuarit për një brez të caktuar,
- si dhe të mundësojë krijimin e një terreni të përshtatshëm për procedurën e dhënies së të drejtave të përdorimit të frekuencave, etj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008, si dhe në zbatim të pikës 2 të nenit 68 të ligjit nr 9918/2008 dhe pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr. 34/2017, duke çmuar rëndësinë e procesit, interesin publik dhe përputhshmërinë ligjore,

V E N D O S:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të Dokumentit: “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)”, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Procedura e këshillimit publik fillon më datë 16. 2. 2017 dhe përfundon më datë 16.04.2018.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti: “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz) – Këshillim Publik” të publikohen në faqen e internetit: www.akep.al
4. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit të Burimeve të Fundme, Autorizimeve dhe Faciliteteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij.

K R Y E T A R

I lir ZELA

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____



DOKUMENT
Për
Këshillim publik

**“Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit
të frekuencave të brezit 800 MHz (790-862 MHz)”**

(Miratuar për këshillim publik me VKD Nr.10 , datë 15.02.2018)

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - AKEP,

Bazuar në:

- nenin 65, nenin 66 dhe nenin 68 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave VKM nr. 277 datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,
- VKM Nr. 635, datë 15.7.2015 “Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar.

a) Me qëllim:

- përmbushjen me sukses të politikës së zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike,
- nxitjen e një konkurrence sa më eficiente në tregun e komunikimeve elektronike dhe përdorimin sa më të frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre nis këshillimin publik për dhënie të drejtash përdorimi të frekuencave të brezit 800 MHz (790-862 MHz).

I. Synimi

Zbatimi i një procesi dhënie të drejtash përdorimi sa me objektiv dhe transparent në përfitim të konsumatoreve shqiptare dhe ekonomisë shqiptare, krijimin e një tregu konkurrues në Shqipëri, përdorimin efektiv të spektrit si dhe përmbushjen e objektivave rregullatore.

II. Zhvillimet kryesore

II.1. Treguesit kryesorë të tregut

Tregu i shërbimeve celulare në Shqipëri është një treg dinamik sa i përket numrit të sipërmarrësve, madhësisë së tregut, investimeve dhe teknologjisë.

Një ndër zhvillimet më të rëndësishme gjatë 2 viteve të fundit ishte fillimi i ofrimit të shërbimeve celulare në rrjetet e gjeneratës së katërt (4G) duke përdorur teknologjinë LTE (Long Term Evolution) e cila u mundësua nga heqja e kufizimeve teknologjike për përdorimin e spektrit në frekuenca të alokuara për të gjithë operatorët celularë si dhe alokimi i brezave të rinj të frekuencave gjatë këtyre viteve.

Të dhënat më të fundit financiare të disponueshme tregojnë se në vitin 2016 të ardhurat nga shërbimet celulare ishin rreth 33.9 miliard lek(ose rreth 253 milionë euro), që përbën një rritje me 2.4% në krahasim me vitin 2015.


Të dhënat më të fundit të disponueshme (tremujori III 2018) tregojnë se numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare sipas kartave SIM në fund të T3 2017 ishte rreth 5.613.000 që përbën një rritje me 4.9% në krahasim me tremujorin e mëparshëm, dhe një rritje me 3.6% në krahasim me T3 2016;


Numri i përdoruesve aktivë (përdorim në 3 muajt e fundit) të telefonisë celulare gjatë T3 2017 arriti në rreth 3.4 milionë ndërkohë që numri i përdoruesve aktivë të aksesit broadband në Internet nga rrjetet celulare në T3 2017 ishte rreth 2.1 milionë që përbën një rritje me 18.4% me tremujorin e mëparshëm, dhe një rritje me 17.8% në krahasim me Tremujorin e tretë 2016.

Totali thirrjeve dalëse të gjeneruara nga pajtimtarët celularë në Shqipëri në T3 2017 ishte rreth 1.7 miliardë minuta, me një rritje prej 0.3 % në krahasim me tremujorin paraardhës, por me një rënie prej 3.9% me të T3 2016.

Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (off-net) u rrit me 0.4% në krahasim me T2 2017 dhe me 9.7% në krahasim me një vit më parë në T3 2016 ndërkohë që sasia e thirrjeve on-net u rrit me 0.2% në krahasim me T2 2017 por pati një rënie me 11.3 % në krahasim me T3 2016. Proporcioni i thirrjeve on-net/off-net në T3 2017 ishte 55%/45% krahasuar me 60%/40% në T3 2016.

Numri i mesazheve SMS të dërguara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare në T3 2017 ishte rreth 336 milion ndërkohë që sasia e trafikut data (Internet) në rrjetet celulare gjatë T3 2017 ishte rreth 12.4 Milion GByte. Një përdorues aktiv i aksesit broadband celular ka përdorur 1.91 GB Internet në muaj në T3 2017, që përbën një rritje të ndjeshme me 153% ose 2.5 herë më shumë krahasuar me konsumin mesatar mujor prej 0.76 GB gjatë vitit 2015. Konsumi mesatar mujor për përdorues aktiv i shërbimeve celulare gjatë T3 2017 ishte: 172 minuta dalëse, 34 SMS dhe 1.91 GB Internet.





Numri i përdoruesve aktivë broadband celulare në T4 2017 arriti në 2 milion, që përbën një rënie me 6% në krahasim me T3 2017 por rritje me 20% krahasuar me T4 2016. Të dhënat tremujore tregojnë për rritje të këtij treguesi në tremujorin e tretë që përkon me sezonin turistik dhe kthimin e përkohshëm të emigrantëve në Shqipëri. Në T4 2017 penetrimi i numrit të përdoruesve aktivë të BB celular për popullsi ishte 72%, pra 72 përdorues aktivë broadband celular për 100 banorë.

II.2. Parashikimet e zhvillimeve në treg

Axhenda digitale e KE dhe propozimet e fundit për rishikimin e kuadrit rregullator të komunikimeve elektronike vënë në dukje nevojën për investime shtesë në rrjete fikse me fibra optike si dhe në rrjetet celulare duke alokuar frekuenca në brezin 700 MHz për këto rrjete, për të mundësuar zhvillimin e rrjeteve celulare 5G, të cilat do të rrisin mbulimin dhe shpejtësinë e aksesit në rrjete broadband.

Rritja e përdorimit dhe cilësisë së shërbimit të aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G ka çuar në rritjen e përdorimit të shërbimeve të aplikacioneve OTT (Over The Top). Zhvillimet e aksesit broadband në rrjete celulare, telefonave smart, OTT vlersohet se kanë çuar në rritje të zëvendësueshmërisë së shërbimeve zanore dhe SMS nga rrjete celulare me shërbime nga këto aplikacione si dhe kërkesë më të lartë për kapacitete transmetimi të dhënash në rrjetet celulare dhe rrjedhimisht në investime më të mëdha nga operatorët e rrjeteve celulare në 4G dhe më vonë dhe në 5G. Efektet zëvendësuese kanë filluar të ndihen këto vite të fundit edhe në Shqipëri për shkak të rritjes së ndjeshme të përdorimit dhe cilësisë së aksesit broadband të mundësuar nga rrjetet 3G dhe sidomos 4G dhe nga rritja e përdorimit të aparateve celulare smart.

AKEP vlereson se ky faktor çon në rritje të konkurrencës potenciale në tregun celularë me pakicë si dhe njëkohësisht në nevojë për investime më të mëdha në rrjete broadband celular për të perballuar kërkesën në rritje për këto shërbime, përfshirë mundësimin e aksesit në brezat 800 MHz për 4G dhe më vonë dhe 700 MHz për 5G.

III. Gjendja aktuale e administrimit dhe përdorimit të spektrit të frekuencave.

Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë, të përcaktuara nga ligji Nr. 9918, i ndryshuar, administrimi i frekuencave bazohet në këto akte nënligjore:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 29.03.2017 “Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave”,
- Plani i caktimit dhe përdorimit të radiofrekuencave në Republikën e Shqipërisë, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr.28, datë 26.10.2017, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave (PKF),
- Parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Dixhital – Dividentit”,
- Rregullore Nr. 30, “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”, datë 05.12.2013, miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2395, datë 05.12.2013.

III.1 Paraqitja e gjëndjes aktuale të shfrytëzimit të spektrit të frekuencave, brezat 900/1800 MHz, 2100 MHz dhe 2600 MHz.

Brezi 900 MHz

Sipërmarres	Brezi i frekuencave, uplink	Brezi i frekuencave, downlink	Teknologjia	Kohezgjatja e Autorizimit
Vodafone Albania	906.6-906.8	951.6-951.8	FDD	Qershor 2030
	907.0 – 914.8	952-959.8		Qershor 2031
	880.4-881.00	925.40-926.00		Qershor 2030
	881.20-881.60	926.20-926.60		Korrik 2030
	882.0-885.8	927.0-930.8		Qershor 2024
Telekom Albania	886.0-889.8	931.0-934.8	FDD	Qershor 2024
	890 - 898	935-943		Gusht 2029
Albtelecom	898 - 906	943 -951	FDD	Mars 2019

Brezi 1800 MHz

Sipërmarres	Brezi i frekuencave, uplink	Brezi i frekuencave, downlink	Teknologjia	Kohezgjatja e Autorizimit
Vodafone Albania	1735.8-1735.9	1830.8-1830.9	FDD	Qershor 2024
	1736.0-1740.2	1831.0-1835.2		

	1740.6-1763.8	1835.6-1858.8		Për 9 MHz : Qershor 2031 Për 14.4 MHz : Prill 2030
Telekom Albania	1710.2-1731.2	1805.2-1826.0	FDD	Për 9 MHz : Gusht 2029 Për 12 MHz : Prill 2030
	1731.4-1735.6	1826.4-1830.6		Qershor 2024
	1735.7-1735.8	1830.7-1830.8		
Albtelecom	1764-1784.8	1859.0-1879.8	FDD	Për 9 MHz : Mars 2019 Për 12 MHz : Prill 2030

Brezi 2100 MHz

Sipërmarres	Brezi i frekuencave, uplink	Brezi i frekuencave, downlink	Teknologjia	Kohezgjatja e Autorizimit
Vodafone Albania	1920-1935MHz	2110- 2125MHz	FDD	Dhjetor 2025
	1965-1970 MHz	2155-2160 MHz		Nentor 2029
	1970-1975	2160-2165		Prill 2031
	1900- 1905MHz		TDD	Dhjetor 2025
Telekom Albania	1935-1950MHz	2125-2140MHz	FDD	Shtator 2026
	1975-1980	2165-2170		Prill 2031
	1905 - 1910 MHz		TDD	Shtator 2026
Albtelecom	1950-1965 MHz	2140-2155 MHz	FDD	Nentor 2027
	1910 - 1915 MHz		TDD	Nentor 2027

Brezi 2500-2690 MHz

Sipërmarres	Brezi i frekuencave, uplink	Brezi i frekuencave, downlink	Teknologjia	Kohezgjatja e Autorizimit
Vodafone Albania	2530 -2550	2650 -2670	FDD	Maj 2030
	2570 MHz-2590 MHz			Maj 2030
Telekom Albania	2510 -2530	2630 -2650	FDD	Maj 2030
Albtelecom	2550-2570	2670 -2690	FDD	Maj 2031

III.2 Gjendja aktuale e shfrytëzimit të këtij spektri në Shqipëri.

Baza ligjore:

1. Ligji Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i cili ka përcaktuar në nenin 136, Kalimi i plotë në transmetimet, numerike:
2. Vendimi Nr. 292 , datë 02.05.2012 “Për Miratimin e Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike” ka përcaktuar:
3. Strategjia Ndërsektoriale “Axxhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020”
4. Vendim i KM nr. 468, datë 30.05.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it” përcakton:
 - Plani Kombëtar për zhvillimin e broadbandit është një dokument strategjik për zhvillimin e infrastrukturës broadband dhe shërbimeve i miratuar me VKM Nr. 468, dt. 30.05.2013. Plani Kombëtar i Broadband-it është një zhvillim i rëndësishëm sepse jep një drejtim të qartë se çfarë do të bëjë Qeveria, administrata publike, rregullatori si AKEP në periudhën 2013-2020. Ai ofron një vizion se si do zhvillohet aksesimi në internet duke u përdorur maksimalisht në familjet shqiptare edhe në zonat më të largëta.
 - Plani Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it përcakton si vizion zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve broadband në të gjithë vendin për të përfutuar akses në shërbimet elektronike në fusha të ndryshme si shëndetësi (e-health), edukim (e-education), tregti (e-commerce), shërbimet qeveritare (e-government) duke nxitur zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

IV. Përdorimi i spektrit të frekuencave, brezi 790-862 MHz.

IV.1 Përcaktimet për përdorimin e brezit 790-862 MHz.

1. CEPT dhe ECC (Electronic Communications Committee within the European Conference of Postal and Telecommunications Administrations) në Maj të 2015 ka publikuar Tabelën Europiane të Alokimit të Frekuencave dhe Aplikimet në brezin 8.3 kHz deri 3000 GHz (ECA TABLE).

Në këtë tabelë brezi 790-862 MHz është përcaktuar për Broadcast dhe Mobile (MFCN) në përputhje me vendimin dhe rekomandimin ECC/DEC/(09)03, ECC/REC/(11)04.

2. Në Konferencën botërore të Radiokomunikacioneve WRC-07 ky brez u bë i disponueshëm edhe për shërbimet e lëvizshme në bazë primare duke marrë në konsideratë 1 Qershorin 2015 (në respekt të GE06) dhe duke e identifikuar këtë brez për IMT, shih RR 5.317A.

Në Konferencën botërore të Radiokomunikacioneve WRC-12 për shërbimet e lëvizshme në këtë brez në Radio Rregullore u bë shënimi përkatës në të cilin është përfshirë edhe Shqipëria.

“5.316A - Additional allocation: in Spain, France, Gabon and Malta, the band 790-830 MHz, in **Albania**, Angola, Bahrain, Benin, Botswana, Burundi, Congo (Rep. of the), Egypt, United Arab Emirates, Estonia, Gambia, Ghana, Guinea, Guinea-Bissau, Hungary, Iraq, Kuwait, Lesotho, Latvia, Lebanon, Lithuania, Luxembourg, Malawi, Morocco, Mauritania, Mozambique, Namibia, Niger, Nigeria, Oman, Uganda, Poland, Qatar, Slovakia, Czech Rep., Romania, Rwanda, Senegal, Sudan, South Sudan, South Africa, Swaziland, Tanzania, Chad, Togo, Yemen, Zambia, Zimbabwe and French overseas departments and communities of Region 1, the **band 790-862 MHz** and in Georgia, the band 806-862 MHz, are also allocated to the mobile, except aeronautical mobile, service on a primary basis subject to the agreement by the administrations concerned obtained under No. 9.21 and under the GE06 Agreement, as appropriate, including those administrations mentioned in No. 5.312, where appropriate. See Resolutions 224 (Rev.WRC 12) and 749 (Rev.WRC 12). This allocation is effective until 16 June 2015”. (WRC 12)’

3. Në Planin Kombëtar të Frekuencave të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” ky brez është përcaktuar për aplikimet Ky brez është planifikuar në të ardhmen për shërbimet e lëvizshme bazuar në dispozitat e RR.

4. Vendimi i Komisionit European i 6 Maj 2010, 2010/267/EU, “On harmonised technical conditions of use in the 790-862 MHz frequency band for terrestrial systems capable of providing electronic communications services in the European Union”.

Më poshtë është tabela përmbledhëse e listës së dokumentave kryesore të CEPT për brezin 790-862 MHz (800 MHz):

ECC/DEC/(09)03	Harmonised conditions for mobile/fixed communications networks (MFCN) operating in the band 790 - 862 MHz
ECC REG/1104	Cross-border coordination of MFCN in the 790-862 MHz
ECC Report 207	Adjacent band co-existence of SRDs in the band 863-870 MHz with LTE usage below 862 MHz
CEPT Report 019	Least restrictive technical conditions for WAPECS frequency bands
CEPT Report 021	Digital Dividend: Technical considerations regarding harmonisation options. Compatibility issues between “cellular / low power transmitter” networks and “larger coverage / high power / tower” type of networks
CEPT Report 022	Digital Dividend: Technical considerations regarding harmonisation options. Technical Feasibility of Harmonising a Sub-band of Bands IV and V for Fixed/Mobile Applications (including uplinks), minimising the Impact on GE06
CEPT Report 023	DD: Use of a Harmonised Sub-Band in the Band 470 - 862 MHz
CEPT Report 029	Digital Dividend: Guideline on cross border coordination issues between mobile services in one country and broadcasting services in another country.
CEPT Report 030	Digital Dividend: The identification of common and minimal (least restrictive) technical conditions for 790 - 862 MHz’
CEPT Report 031	Digital Dividend: Frequency (channelling) arrangements for the 790-862 MHz band’

Dokumentat e mësipërme midis të tjerash kanë përcaktuar edhe:


- kushtet teknike për optimizimin e rrjeteve MFCN në brezin 790-862 MHz duke bërë të mundur mbrojtjen e shërbimeve audiovizive në përputhje me GE-06 dhe aplikimeve të tjera;
- Konsiderata teknike lidhur me harmonizimin dhe çështje të kompatibilitetit të rrjeteve celulare/transmetim me fuqi të ulët dhe rrjeteve me mbulim maksimal/fuqi të lartë/kullë.

IV.2 Përcaktimet për mënyrën e shfrytëzimit të brezit 790-860 MHz.

1. Vendimi ECC/DEC/(09)03, për kushtet e përdorimit MFCN në brezin 790-862 MHz, “ECC Decision of 30 October 2009 on harmonised conditions for mobile/fixed communications networks (MFCN) operating in the band 790 - 862 MHz”.
2. Brezi i frekuencave 790-862 MHz është projektuar për rrjetet MFCN (mobile/fixed communications networks).
3. Administratat që dëshirojnë të implementojnë rrjetet MFCN bazuar në sistemet FDD duhet të përdorin harmonizimin e dhënë në Aneks-e.

V. Eksperienat ndërkombëtare

Në Rajonin 1 (sipas ITU) CEPT, brezi 800 MHz ka mbi pesë vjet që ka filluar të jepet në përdorim edhe për shërbimet e lëvizshme. Kjo sepse dhënia në përdorim e këtij brezi përveçse ka ardhur si domosdoshmëri e rritjes së trafikut të të dhënave që transmetohen por edhe për shkak të ndikimit të drejtëpërdrejtë në nivelin ekonomik të vendeve (GDP).



Aneksi 1

Harmonizimin i frekuencave

790-791	791-796	796-801	801-806	806-811	811-816	816-821	821-832	832-837	837-842	842-847	847-852	852-857	857-862
Guard band	Downlink						Duplex gap	Uplink					
1 MHz	30 MHz (6 blocks of 5 MHz)						11 MHz	30 MHz (6 blocks of 5 MHz)					

- Spektri i disponueshëm 2x30 MHz me një Gap duplex prej 11 MHz. Madhësia e bllokut 5 MHz i çiftuar. Guard band prej 1 MHz në fillim të 790 MHz. FDD downlink fillon në 791 MHz dhe FDD uplink fillon në 832 MHz.
- Nëse do të implementohet ndryshe nga sa përcaktohet në aneksin 1 duhet të përdorin harmonizimin e dhënë në tabelën e mësipërme.

Aneksi 2

Udhëzime për administratat që nuk implemetojnë ndarjen e frekuencave

Administratat të cilat nuk dëshirojnë të implemetojnë ndarjen e frekuencave të harmonizuara siç përshkruhet në Aneksin 1 ose që nuk e kanë të plotë brezin 790-862 Mhz në dispozicion (P.sh. kur një Administratë nuk i ka të gjitha kanalet e brezin të disponueshme për shkak se ato tashmë janë ndarë për shërbime të tjera ose nuk janë në gjendje të koordinojnë përdorimin e frekuencave me vendet fqinje) mund të marrin në konsideratë:

Zbatimi te pjesshëm të ndarjes së frekuencave të përshkruar në Aneksin 1.

Futja e rregullimit të frekuencës TDD në të gjithë ose një pjesë të brezit të frekuencave 790-862 MHz, bazuar në një madhësi blloku 5MHz duke filluar nga 797 MHz, me një brez mbrojtës prej 7 MHz duke filluar nga 790 MHz.

790-797	797-802	802-807	807-812	812-817	817-822	822-827	827-832	832-837	837-842	842-847	847-852	852-857	857-862
Guard band	Unpaired												
7 MHz	65 MHz (13 blocks of 5 MHz)												

- Futja e përzier e ndarjes së frekuencave TDD dhe FDD siç përshkruhet në Aneksin 5 të Raportit CEPT 31.
- Zbatimi i një kanali raster prej 1 MHz.

Duhet të theksohet se:

- filtrimi kërkohet në marrësin DTT për operimin TDD në bllokun më të ulët 5 MHz të ndarjes së frekuencës TDD, siç përshkruhet në Aneksin 3 të Raportit CEPT 30;
- administratat që dëshirojnë të mbrojnë marrjen e DTT të brendshëm portativ do të duhet të miratojnë një guard band që është më i madh se 7 MHz dhe gjithashtu mund të kërkojë filtrim në marrësin DTT, siç përshkruhet në Aneksin 3 të Raportit CEPT 30.

Ndarja për TDD bazohet në madhësi blloku 5 MHz duke filluar nga 797 MHz me një guard band prej 7 MHz që fillon nga 790 MHz.

Një përdorim miks FDD dhe TDD përshkruhet në raportin 31 të CEPT dhe implementohet me kanal raster prej 1 MHz. Në këtë raport trajtohen edhe çështjet e mbrojtjes për DTT.

- (i). Aneksi 3 i këtij vendimi përcakton kushtet teknike të përdorimit sipas dy metodave të përshkruara në anekset e mësipërme.

- (ii). Rekomandimi ECC (11)04 “Mbi planifikimin dhe koordinimin e frekuencave për sistemet tokesore MFCN të disponueshme për shërbime të komunikimeve elektronike në brezin e frekuencave 790-862 MHz” përcakton:
- Koordinimi në zonat kufitare duhet të bazohet në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe midis administratave.
 - Koordinimi midis sistemeve MFCN dhe shërbimeve të tjera në vendet fqinje duhet të bazohet në marrëveshjet dypalëshe/shumëpalëshe të cilat do të përcaktojnë koordinimin për ndërfaqjet radio në dy anët e kufirit.
 - Koordinimi midis sistemeve FDD MFCN, TDD MFCN duhet të bazohet në përcaktimet e ankesave përkatëse të këtij rekomandimi.
 - Operimi i sistemeve LTE në zonën kufitare duhet të bazohet në “PREFERENTIAL PHYSICAL-LAYER CELL IDENTITIES (PCI) FOR IMT-2000/LTE” të përcaktuar në këtë rekomandim.

(iii). Standarti teknik

Sipas përcaktimit në tabelën ECA standarti që duhet të aplikohet për sistemet që do të aplikohen në këtë brez është ETSI EN 301 908: “IMT cellular networks; Harmonized EN covering the essential requirements of article 3.2 of the R&TTE Directive”

- (iv). Një çështje themelore dhe pikë fokusuese është koncepti i neutralitetit. Është esenciale të marrësh në konsideratë neutralitetin teknologjik dhe atë të shërbimeve nën konceptin e politikave të aksesit pa tel për shërbimet e komunikimeve elektronike.

Aplikimi i "neutralitetit", mbështetet në përcaktimin e një numri minimal të parametrave në të cilën një sistem i caktuar radio duhet t'i përmbahet. Për më tepër, nga pikëpamja inxhinierike e spektrit, implementimi i një sistemi radio në një brez frekuencash të veçantë kërkon marrjen në konsideratë të shumë parametrave (p.sh., specifikat e transmetuesit dhe marrësit, apo metodat e aksesit TDD, FDD), e cila shkon përtej qasjes së përgjithshme për të pasur një analizë të thjeshtë (p.sh., bazuar vetëm në maskën e spektrit).

VI. Pyetjet

1. Mënyra e ndarjes së spektrit

Për mënyrën e shfrytëzimit të brezit 790-862 MHz duhet konsideruar:

- *Sasia e spektrit për bllok*
- *Guard band*
- *Gap.*

Ka disa teknologji që mund të aplikohen në brezin 800 MHz si HSPA, LTE etj dhe këto teknologji kërkojnë madhësi karrierash të ndryshme.

Duke qenë se teknologjitë “Next Generation” si LTE aplikojnë për konfigurimin e sistemeve një minimum gjerësi brezi prej 5 MHz rekomandojmë të aplikohet ndarja e mëposhtme:

790-791	791-796	796-801	801-806	806-811	811-816	816-821	821-832	832-837	837-842	842-847	847-852	852-857	857-862
Guard band	Downlink						Duplex gap	Uplink					
1 MHz	30 MHz (6 blloqe 5 MHz)						11 MHz	30 MHz (6 blloqe 5 MHz)					

Bazuar në ndarjen e mësipërme si dhe karakteristikat teknike të sistemeve LTE, AKEP mendon se numri minimal i të drejtave të përdorimit i mjaftueshëm dhe i duhur për ngritjen e sistemeve LTE në këto breza është 2 (dy) të drejta dmth 2x2x5 MHz ose ndryshe 2x10 MHz sëbashku.

Mendimi juaj për këtë vlerësim.

2. Bazuar mbi këtë propozim cila është vlera që jeni gati të paguani për të drejtë përdorimi 2x5 MHz?

Mendimi juaj për këtë çështje.

3. Procedura e konkurrimit publik

Për përzgjedhjen e fituesve do të aplikohet procedura e tenderit publik, “Procedurë e hapur”, përcaktuar në Vendimin Nr.1252, datë 10.09.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar.

Mendimi juaj për këtë çështje.

4. AKEP për dhënien e të drejtave të përdorimit në këto breza do të aplikojë “Metodën e vlerësimit me raunde”.

Mendimi juaj për këtë çështje.

5. Kushtet përmbulimin me shërbim në shkallë gjeografike

Propozojme që kushtet e mbulimit me shërbime broadband në shkallë gjeografike të krahasohen me eksperimentat e ngjashme në vendet europiane. Jo më pak se 25 % e territorit në 6 muajt e parë të përdorimit të frekuencave.

Mendimi juaj për këtë çështje.

6. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit

AKEP mendon që kohëzgjatja e vlefshmërisë së autorizimit të lëshuar të jetë 15 vjet.

Mendimi juaj për këtë çështje.

7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.635, datë 15.07.2015, “Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Rregullave të Zhvillimit të Tenderit Publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar, parashikon përfshirjen edhe të mënyrës së pagesës së autorizimit individual në Dokumentin e Tenderit.

Mendimi juaj lidhur me mënyrën e pagesës dhe aplikimin e pagesës me këste në këtë procedurë.

8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.635, datë 15.07.2015 parashikon se në rastin e aplikimit të pagesave me këste, ofertuesi paraqet bashkë me ofertën dhe propozimin për kalendarin e pagesave pa cënuar të drejtën e çdo ofertuesi për paraqitjen e ofertës me një pagesë të vetme me marrjen e autorizimit.

Mendimi juaj për kalendarin e pagesave.

9. Në se do të rezultoni fitues i një të drejtë përdorimi, cila është teknologjia që do të aplikoni për ndërtimin e rrejtit të aksesit?

Mendimi juaj për këtë çështje.

10. Argumentat nëse kenë ndonjë çështje tjetër për t’u marrë në konsideratë.